



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Komitetit për Komunitete
Z./Znj. _____

Në bazë të nenit 53 të Ligjit për Qeverisje Lokale dhe nenit 42 të Statutit të Komunës së Novobërdës:


F T O J

Mbledhjen e dytë të Komitetit për Komunitete e cila do të mbahet më 15.02.2019 (e premte) duke filluar në orën 10:00.

R e n d i d i t ē s

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit;
2. Raporti gjashtëmujor nga Zyra për Kthim dhe Komunitete;
3. Raport nga Drejtoria e Arsimit për përfundimin e gjysëmvjetorit të parë dhe fillimin e gjysëmvjetorit të dytë;
4. Të ndryshme;

Me: 11.02.2019
Në: Novobërdë



Shpresa Kqiku
Kryesuese e Komitetit për Komunitete



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e parë e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 16.01.2019, duke filluar në orën 10:00. Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja e Komitetit për komunitete Shpresa Kqiku, Anëtarët e Komitetit: Dobrivoje Djordovic, Aleksander Pavic, Abdyl Gashi, Behare Jashari, Nënkyetari për Komunitete Bajrush Ymeri, Drejtoresha e Sherbimeve Publike Shefki Mehmeti dhe përfaqësuesit e OSBE-së.

Kryesuesja e Komitetit pasi përvendos që pranishmit tha: e hapi mbledhjen me këtë:

Rend dite

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit;
2. Diskutim rrith mirëmbajtjes dimërore të rrugëve Lokale;
3. Të ndryshme;

Kryesuesja i pyeti se a kan ndonjë propozim apo pajtohen me këtë rend ditë?

Dobrivoje Djordjevic pasi përvendos që pranishmit tha: herën e kaluar kemi vendosur që të votojm se kush është për, pra të aprovohet rendi i ditës.

Aleksander Pavic pasi përvendos që pranishmit tha: pra se të hudhet në votim është mirë që të pytet se a ka ndonje plotësim apo propozim e mandej të votohet.

Pasi nuk pat diskutime tjera aprovohet njëzëri rendi i ditës nga antarët prezent.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit;

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Dobrivoje Djordjevic tha: nuk kam ndonjë vërejtje vetem se në mbledhjen e kaluar nuk e kemi pasur procesverbalin në gjuhën serbe dhe nuk kemi votuar për procesverbal e në këtë mbledhje është duhur që ti kemi të dy procesverbalet.

Kryesuesja tha: perkthyesi gjendet në pushim dhe perseri nuk ka mundur ta perkthej.

Abdyl Gashi tha: po kyçem edhe pse është duhur flas para se të votohet rendi i ditës, pasi që ka pasur hapsir të futen edhe pika tjera e jo vetem me një pikë ta mbajmë këtë mbledhje të komitetit, në anen tjeter po e vërejm edhe mungesen e Kryesuesit, zv.Kryesuesit , Kryetarit dhe Nënkyetarëve, po duket se është një interes i tyre që Komitetit për Komunitete me lënë në hije duke e pasur parasysh se është një komitet i nevojshëm në Komunën tonë për arsy se jetojnë shumë etni në Komunën tonë, nuk e di a u janë derguar ftesa Kryesuesit, zv.Kryesuesit, Kryetarit dhe Nënkyetarit për arsy që mos të mbesim veç hije siç po ndodhë në çdo mbledhje. Ne ende nuk e kemi një plan të punës për vitin 2019 me vepru si Komitetbesoj se Komiteti duhet të pregaditet edhe muajin e katër dhe të pestë në mënyr që të dim se çka do të na presë, ju faleminderit.

Kryesuesja tha: do ta kemi parasysh që të bëjm një plan të punës.

Pasi nuk pat diskutime tjera procesverbali aprovohet njëzëri nga antarët prezent.

Pika e dytë: Diskutim rreth mirëmbajtjes dimërore të rrugëve Lokale;

Kryesuesja tha: Duke e pasur parasysh që këtyre ditëve kemi pasur mjaftë të reshura të borës natyrisht që kemi pas edhe kërkesa nga qytetarët tanë për pastrimin e rrugëve të tyre që kanë qenë të mbuluara nga bora. Kërkesat kanë qenë telefonike në emër timin dhe nënkyetarit për Komunitete z.Bajrush Ymeri.

Lartësia mbidetare e Komunës sonë është më e lartë se në Komunat tjera, andaj kemi edhe reshje të borës më shumë se në vise më të ulëta. Kjo duhet të na bëjë me dije se ne duhet të jemi më të përgaditur gjatë sezonës së dimrit.

Edhe pse këtyre ditëve ka pasë të reshura me gjithat situata ka qenë e mirë sepse kompanitë që janë të kontraktuara nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës kanë bërë pastrimin e rrugëve regionale që lidhin Prishtinën me Gjilanin e po ashtu edhe rrugët Llabjan-Novobërdë dhe rrugën Novobërdë-Makresh i Epërm-Stanishor-Gjilan kanë qenë të qarkullueshme. Sa i përket rrugëve lokale zjarrëfikësat tanë me kamionin e Komunës sa kanë pasur mundësi ju kan dal në ndihmë qytetarëve tanë në pastrimin e rrugëve lokale por natyrishtë tereni është shumë i gjerë andaj edhe kanë pas vështërsi. Shfrytëzoj rastin të falenderoj ekipin e zjarrëfiksave të Komunës sonë për angazhimin e tyre gjatë këtyre ditëve. Meqë e kemi situaten e tillë unë kisha kërku nga Kryetari i Komunës që të kontraktoj një komapni që bënë mirëmbajtjen e rrugëve gjatë sezonit të dimërit sepse ky vetem se është fillimi i dimërit dhe mundë të kemi të reshura të borës edhe më të mëdha dhe vështirë se mund të ja dalim vetëm me kamionin e Komunës dhe zjarrëfikësit sepse fundja ata nuk janë përgjegjës për pastrimin e rrugëve. Poashtu një shqetësim që e kemi marrë prej banorëve tanë është edhe për trotuaret e papastruara sepse kamionët gjatë pastrimit të rrugëve tërë borën që e largojnë e hudhin në trotuare dhe pastaj është e pamundur që qytetarët dhe nxënësit të lëvizin nëpër trotuare dhe si pasojë e kesaj qytetarët dhe nxënësit janë të detyruar të lëvizin nëpër rrugë dhe me këtë rastë ju ekspozohen rrezikut të aksidenteve nga automjetet që lëvizin. Prandaj është kërkesë urgjente dhe shumë e nevojshme që trotuaret aty ku i kemi të ndërtuara të pastrohen. Është mirë të ndërmirren këto hapa në mënyrë që të parandalojmë të keqen që mundet me na ndodhë, prandaj po kërkoj nga egzekutivi i Komunës që trotuaret të pastrohen.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Shefkije Mehmeti pasi përvendoset që pranishmit tha: sa i përket pastrimit të rrugëve nga Drejtoria dhe egzekutivi është bërë maksimumi duke ju falenderuar Ministrisë së Infrastrukturës, Drejtorisë së Emergjencave në Regionin e Gjilanit, Emergjencave në Ministrin e Punëve të Brendshme në Prishtinë duke ju falenderuar edhe FSK-së, Kryetarit të Komunës, Zjarrëfiksëve që kanë qenë në teren deri në orët e vona mirëpo ne e dim situaten në Komuënn tonë dhe ne nuk mundëti pastrojmë trotuarët kur rrugët janë të bllokua. Së pari duhet të pastrohen rrugët pasi që kemi qytetarë të sëmur me kancer, ndërsa trotuarët mundet edhe vet qytetarët ti pastrojnë. I falenderoj qytetarët e Stanishorit pasi që në të dy pjesët e trotuarëve i kan pastruar vet dhe një pjesë të madhe të rrugës vet e kanë pastruar, ne jemi duke bërë maksimumin që ta bëjmë pastrimin e rrugëve. Dy ditë me radhë Ministria e Infrastrukturës na ka derguar Kamionin ku kemi bërë pastrimin e rrugëve në Jasenovik, në Makreshë të eperm dhe të poshtem, Tullarë në Llabjan zjarrfiksat gjatë gjithë kohës kanë qenë në teren por arsyse se kamionet të cilët vin prej Ministrisë nuk i pastrojnë rrugët lokale pasi që janë të ngushta. Por edhe qytetarët tonë nuk kanë aspak durim, ne i dergojm zjarrëfiksat që ta pastrojn rrugen në Llabjan dhe duhet ti pastroj të gjitha rrugët e nuk mundet prej Llabjanit të shkoj në Makreshë, duhet ta planifikoj punën. Sa i përket trotuarëve secili Institucion duhet ta pastroj trotuarin perpara. Mua më vjen keq prej të sëmurëve që duhet të shkojm të ja pastrojm rrugën në çfarë do kohe duhet të jemi para këtyre qytetarëve ndërsa trotuarët minden edhe vet qytetarët ti pastrojnë.

Dobrivoje Djorjevic tha: faleminderit Drejtoreshë për informim, një sugjerim pasi që po thoni se duhet të pastroj secili para institucionit të vet por parkingu i Komunës është i papastruar.

Shefkije Mehmetit tha: e di, ju kam thënë që ta pastrojnë por nuk e kanë pastruar.

Dobrivoje Djordjevic tha: një fëmij duke shkuar në shkollë është rrëzuar pasi që trotuatret nuk kanë qenë të pastruara perpara shkollës, kjo është më shumë për Drejtorin e Arsimit, por ashtu siç tha Drejtoresha janë mësuar që të gjitha punët të kryhen prej dikujt tjeter. Mundë të them se në Komuënnë e Novobërdës të gjitha rrugët janë përfekte të pastruara mirë.

Behare Jashari pasi përshtendeti të pranishmit tha: pajtohem me ju Drejtoresh pasi që trotuaret mundën edhe vet qytetarët ti pastrojnë, ndërsa sa i përket rrugëve duhet të jen të pastruara pasi që ka ndodhur një rast autobusi i cili i transporton nxënësit për në shkoll i ka zbritur në Llabjan për arsy se rruga ka qenë e papastruar dhe nuk ka mundur të kaloj që ti kthej nxënësit në shtepitë e tyre.

Shefkije Mehmeti tha: rrugët regionale janë të pastruara çdo herë pasi që mirëmbahen prej Ministrisë së Infrastrukturës.

Abdyl Gashi tha: i kam disa pyetje teknike, kur është lidh marrëveshja me kompanin e kontraktuar për pastrimin e rrugëve dhe cilat janë mekanizmat që Komuna i ka në dispozicion?. Në njëher an po pajtohem se shkollat, ambulantat të pastrojn vet trotuaret, poashtu nuk pajtohem nese një prind është i papergjegjshëm dhe nuk e pastron trotuarin para deres dhe femija i tij 5 vjeçar shkelet për arsy të mos pastrimit të trotuarit, mendoj se është munges e strategjis dhe planit të punës se qysh e sheh Komuna pastrimin e rrugëve.

Dobrivoje Djordjevic tha: vetem të lidhem me diskutimin e koleges më herët lidhur me autobusin mos ka qenë deshir e vozitësit që mos ti sjell nxënësit në vendin e tyre. Pajtohem me kolegut se askush nuk vjen para shtëpis ta pastroj dhe nuk po them qe të dalin mësimdhënësit të pastrojn por janë puntorët teknik.

Abdyl Gashi tha: po e kuptoj kulturen dhe nuk jam që mësimdhënësit apo mjekët mos ta bëjnë këtë punë dhe fëmijet duke shkuar në institucione me pësu aksident. Prej fshatit Llabjan e deri në Koznic dhe Llajshevë është e pamundur me u pastru prej qytetarëve, e njejtë situat është prej fillimit të Pasjakit me pastru vet qytetarët, aksuh nuk mundet qe 2-3 ditë të ja kushtoj pastrimit të trotuarëve.

Bajrush Ymeri pasi përshtendeti të pranishmit tha: kërkoj falje për vonesen, pasi që me të vërtet kam qenë i interesuar që ta dëgjoj këtë diskutim , siç e dini këto ditë kemi pasur të reshura natyrisht pak më shumë se në rajone të tjera për arsy të lartësisë dhe natyrisht kur ka bllokime të rrugëve qytetarët na telefonojnë. Gjatë gjitha kohës kam marrë telefonata por fatkeqësish nuk kam pasur mundësi shumë me i ndihmu, natyrisht ekipi i zjarrëfiksëve më respektojnë por jo me një fuqi si Nënkyetar Komune që muj me urdhëru dhe kjo po ndodh për arsy se dikush tjetër i ka marrë këto punë dhe unë po e shoh se ju po i referoheni si Drejtoreshë por Shefkije mehmeti nuk është më Drejtoreshë, nuk e di edhe pse e ka marrë barren e huj që të mirret me këtë punë, nuk e di nese e ka autorizuar dikush. Atë që e permendi zt.Gashi për trotuarin në Llabjan dhe Koznic una kam pasur dje thirrje telefonike drejperdrejt nga TV Dugagjini prej qytetarëve që kanë thirrë, natyrisht kam kérkuar nga ekipi i zjarrëfiksëve por është e pamundur më kamion të pastrohen trotuaret, thjesht nuk jemi të pregaditur mjaftueshëm me u perballu me këtë situat. Kam dëgjuar se është një kompani e kontraktuar por nuk e kam parë në terren se është duke punuar, prandaj le të jetë kérkes që urgjentisht të mirren masa në këtë drejtim, nese nuk kanë kontraktuar ndonjë kompani të kontaktohen dhe të mobilizohen pasi që dimri veç sa ka filluar.

Shefkije Mehmeti tha: sa i përket autorizimit jamë e autorizuar nga dikush që e mbaj këtë përgjegjësi dhe zjarrfiksave nuk ju them që të dalin nën terren vetem në rrugë që kanë mundesi të pastrojn pasi që kamioni është i vogel.

Ramush Mehmeti pasi përshtendeti të pranishmit tha: kërkoj falje për vones por ftesë nuk kam marrë, vetem rastësisht erdha mundet me qenë gabim teknik. Sa i përket temes e kam një sheqtësim pasi që

mbrëmë ka ardhkamioni i Komunës e ka pastruar rrugën deri të shpijat e punëtorëve të Komunës vetem në lagjen tem nuk e ka pastruar. Ju kish lut të mos bëni dalllime në apsketin politik, e kuqtoj se një kamion nuk mundeti ti pastroj të gjitha rrugët por kur të vjen deri afër dhe vetem një rrugë mos ta pastroj është turp, ju faleminderit.

Pika e tretë: Të ndryshme;

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Abdyl Gashi tha: edhe para se të vim të kjo pikë e ngrita shqetësimin se nuk u janë dërguar ftesat Nëkryetarëve, Kryetarit. E kemi parë një lloj provokimi lidhur me kalanderin 2019 mendoj që ne si komitete për komunitete duhet të punojmë që këto gjera mos të ndodhin përseri, në njëren anë është trashigimi kulturore e Serbisë e në anen tjetër e bënë një ndarje me një xhami të komitetit Shqiptarë. Mendoj se Komuna e Artanës është shume e pasur me bukuri natyrore, xehe dhe kalan, mendoj se kishte posur mundësi të jetë një kalendar i përbashkët me fotografi të përbashkëta dhe jo të kemi kësi lloj provokime që nuk kontribojnë në integrimi të komuniteteve. Mendoj se personat përgjegjës duhet të vin këtu dhe të raportojnë, gjithashtu ne duhet të bëjm një plan të punës, nuk e di se çka ne do të diskutojm për mbledhjen e ardhshme.

Bajrush Ymeri tha: natyrisht me ligj dhe rregulllore para se ta bënë rendin e ditës duhet të konsultoheni edhe me Nënkyetarin për komunitete, zv.Kryesuesin për komunitete dhe shefen e ZKKK, shumë takim që i ka organizuar OSBE-ja është përmendur vazhdimisht puna e ngusht mes këtyre mekanizmave që mbrojn dhe promovojn të drejtat e komuniteteve por natyrisht nuk ka asgjë të keqe që edhe këtu të diskutohet për ndonjë pikë për mbledhjen e ardhshme.

Kryesuesja tha: ju kam thënë edhe më heret që nese kanë ndonjë pikë për të propozuar të më telefonojn ose të propozojnë këtu.

Abdyl Gashi tha: ne po vim këtu por ka shumë qështje që janë në mjegull dhe nuk po i dim, në fund të muajit të kaluar janë shpernda disa kultivator dhe nuk e dim se kujt u janë dhënë, aspo sa jënë ndarë për komunitetin Serb dhe sa Shqiptarë, për vjedhjet e fundit janë ndarë 5,000€ dhe nuk e dim se kujt ju kanë ndarë këto mjete a kan shkuar në vendin e duhur.

Dobrivoje Djordjevic tha: është e domosdoshme që shefja e zyres së kthimit të jetë këtu por ajo nuk është prezent, nuk e di a i është derguar ftesa pasi që ajo gjithmonë ankohet se nuk po merr ftesa për takim. Siç tha edhe kolegu që mbledhja të mos mbahet vetem për meditje me një pikë në rend dite.

Behare Jashari tha: kam degjuar se janë ndarë disa kultivator po ju pyes pse komuniteti rom nuk kanë marrë, nese mundet Nënkyetari të na njoftoj.

Bajrush Ymeri tha: nuk kam shumë informata pasi që nuk kam marr pjesë në ndarje të këtyre subvencioneve, është mirë me bë kérkes e ndoshta raporton dikush në mbledhjen e ardhshme nuk e di nese ka aplikuar dikush nga komuniteti rom, aplikimi ka qenë më heret dhe kan qenë njoftimet edhe ne web faqe të Komunës, numri i atyre që kanë aplikuar natyrisht se ka qenë më i madhë se i atyre që kanë përfituar, nuk jam i sigurt se kam parë ndonjë emer nga komuniteti rom.

Behare Jashari tha: edhe për shperndarje të druve kanë marrë vetem këta që po punojnë në Komunë e nuk kan marrë rastet sociale ose penzioneret.

Ramush Mehmeti tha: sa për njoftim për arsyet e mosraportimeve, për arsyet të motransparencës, për arsyet e mosbatimit të ligjit Kuvendi në dhjetor ka marrë vendim që Kryetarit të Komunës ti mirret e drejta e subvencioneve. Ju si antarë të komitetit për komunitete për këtë arsyet jeni të thirrur që ti prezantoni problemet këtu.

Pasi nuk pati diskutime tjera Kryesuesja i falëndëroi të pranishmit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi ne ora 11:00

Valmire Mustafa

Procesmbajtëse



Shpresa Kqiku
Kryesuese i Komitetit për Komunitete